

STATUT I SHOQËRISË
“Bio Farm 2000”shpk

Sot, me datë 18.03.2021, Ortak I vetem themelues:

Hamdi Goga, i biri I Isuf-it, shtetas i Republikese Shqiperise, lindur me 27.03.1982,ne Tirane dhe banues ne Tirane, i pajisur me pashaporte me nr. Personal I20327173D madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, vendosi miratimin e ketij Statuti me termat e meposhtem:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqeria Tregtare “Bio Farm 2000” shpk rregullon poziten e saj juridike, marredheniet e themeluesve, te organeve te saj, llojin e Shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj, marredheniet me te punesuarit, duke u bazuar ne ligjin nr. 9901, te dates 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar ne fuqi qe rregullojne marredheniet e Shoqerive Tregtare, si dhe kete Statut.

Neni 1

Shoqeria gezon te drejta si person juridik, qe prej dates ne te cilen kryhet regjistrimi i saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 2

Forma e Shoqerise

Shoqeria do te kete formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar.

Kjo shoqeri do te perballoje humbjet e saj deri ne vleren e kapitalit themeltar te saj te paraqitur ne kete Statut.

Neni 3

Emerimi Tregtar

Emri Tregtar i Shoqerise eshte “Bio Farm 2000” sh.p.k. .



Neni 4
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: Tiranë, TIRANË Njesia Administrative Nr.5, rruga "Skender Luarasi", pallati 1, shkalla 1, kati

Shoqëria me vendim të Asamblesë së Ortakeve, mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësive, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Objekti i Veprimtarisë

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

1. Aktivitet ekonomik në fushën e Agroturizmit, shërbime Tregëti me pakicë Fruta - Perimeve artikujve bujqësorë e blegtoral organikë, natyrale dhe biologjike.

Objekti i shoqërisë mund të plotësohet e modifikohet në çdo kohë me miratimin në përputhje me ligjet përkatëse. Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me të.

Neni 6
Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor 5- vjeçar, Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 7
Kapitali

Kapitali i shoqërisë do të jetë 500.000 (pesëqind mijë) leke, i zotëruar si më poshtë:

Nr.	Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
1	Hamdi Goga	100%	1

Ky kapital i përket aksionerit të vetëm të shoqërisë.. Kuotat e Kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, pasi të jetë marrë miratimi i



ortakeve te tjere te shoqerise, duke respektuar te drejten e parablerjes, kur transferimi behet me ane te shitjes.

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet por jo nen vleren nominale 500.000 leke

Neni 8

DREJTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj **Hamdi Goga**, ortaku i vetem dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i shoqerise ne mardhenjie me te tretet dhe ka kopetenca te plota ne drejtimin e saj. Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga perfaqesues i paisur me prokure te posacme

Neni 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem

Neni 10

Kompetencat e Asamblesë

Asambleja e Pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:

- Te percaktojë politikat tregtare të shoqërisë;
- Te vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me eksperte të caktuar prej tij;
- Te vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Te vendosë për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Te ushtrojë të drejta të tjera që parashikohen në ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 11

Administrimi i shoqërisë

Ortaku I vetem ka te drejte te emeroje nje administrator, financiere, likujdator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake



Neni 12
Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

Neni 13
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 14
Të ndryshme

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky Statut vlejné dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, pjesa e parë mbi “Dispozitat e Përgjithshme”, pjesa e katërt për “shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar” si dhe aktet ligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

Statuti u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t’u administruar në bazë të ligjit, një kopje për tu dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe dykopje mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

“Bio Farm 2000”

HAMDI GOGA

Hamdi Goga
